



Informacione për adoleshentët dhe të rinjtë: Kush? Çfarë? Si?

Trajtimi i rasteve të trajnimit profesional

KUSH?

Kujt i drejtohet Trajtimi i rasteve të trajnimit profesional?

Trajtimi i rasteve të trajnimit profesional i drejtohet adoleshentëve të Kantonit të Bernës nga moshë 14 vjeç dhe të rinjve deri në moshën 25 vjeç me “vështirësi të ndryshme” gjatë hyrjes në botën e punës.

Çfarë janë “vështirësitë e ndryshme”?

Për mua janë të vlefshëm shembujt e mëposhtëm ose tema të ngjashme:

- Nuk kam ende një zgjidhje për vazhdimin e shkollës
- Familja ime nuk e njih mirë sistemin shkollor zviceran dhe nuk më ndihmon dot
- Kam vështirësi në sferën shkollore, shëndetësore, familjare ose sociale

ÇFARË?

Trajtimi i rasteve të trajnimit profesional është një shërbim pa pagesë dhe vullnetar. Një menaxher/e i/e rastit (CM), të mbështet dhe të shoqëron nga arsimi i detyrueshëm deri në përfundimin me sukses të një arsimi bazë profesional.

Çfarë duhet të bëj?

- Bashkëpunoj në mënyrë aktive
- Respektoj marrëveshjet e përbashkëta
- Qëndroj në kontakt
- Dua të arrij qëllimin tim
- Dua të kem mbështetje

SI?

Cila është situata ime?

I përshkruaj CM-së se cila është situata ime në shkollë, në familje dhe në kohën e lirë.

Së bashku zbulojmë se përse kam vështirësi për të ecur përpara dhe cilat janë pikat e mia të forta.

CM-ja diskuton me mua dhe analizon më së bashku situatën time aktuale.

Unë jap miratimin tim për marrjen e informacioneve nga institucione dhe specialistë të tjerë, për të marrë vlerësimet e tyre dhe për të klasifikuar problemet e ndryshme. Kështu mund të më mbështesë CM-ja.

Firmosim së bashku një marrëveshje për të garantuar mbrojtjen e të dhënave.

Si i arrij objektivat e mia?

Për të arritur objektivin tim, përkatësisht përfundimin me sukses të arsimimit tim, diskutojmë së bashku se çfarë më nevojitet. Ne caktojmë objektiva të pjesshme së bashku dhe mendojmë se si mund të arrihen ato.

Unë duhet të bie dakord me planet tona , të jem aktiv dhe t'i përmbahem marrëveshjeve.

CM-ja më ndihmon të organizohem me specialistët e tjerë që mund të më ofrojnë më shumë mbështetje në arritjen e objektivave të mia. Objektivat e pjesshme të mundshme mund të jenë:

- Gjetja e profesionit për të cilin dua të formohem
- Organizimi i procesit të kërkimit të trajnimit ose praktikës
- Përgatitja e dosjes sime të aplikimit
- Zgjerimi i njohurive shkollore
- Sqarimi nëse më nevojitet mbështetje mjekësore
- Organizimi i mbështetjes terapeutike ose shpjegimeve

Sa zgjat mbështetja?

Është e rëndësishme që të mund të hyj në botën e punës dhe të kem një kualifikim profesional. Gjatë këtij rrugëtimi do të mbështetem dhe do të shoqërohem nga CM-ja, sipas nevojës.

Trajtimi i rasteve të trajnimit profesional do të përfundojë, kur, për shembull:

- të kem arritur objektivat që i kam vënë vetes
- nuk kam respektuar herë pas here marrëveshjet
- kam ndërprerë kontaktin me CM-në
- kam ndjekur me sukses për një kohë të gjatë arsimimin dhe nuk më nevojitet më mbështetje
- kam përfunduar me sukses arsimimin tim